



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV**

Nr. 463 / prot.
3

Tiranë më 6.04.2018

REKOMANDIM

Nr. 12 , datë 6 .04.2018

PËR KONTROLLUESIN "BANAJ STUDIO SHPK"

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 31 pika 1, gërma a/1 dhe 32 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, neneve 77-112 të Ligjit Nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "Banaj Studio shpk".

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit Nr.91 datë 07.03.2018 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit Shoqëria "Banaj Studio shpk", me objekt kontrolli:

- Zbatimi i Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit Shoqëria "Banaj Studio shpk".

Në funksion të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, Shoqëritë e vlerësimit të pasurive të paluajtshme, janë kontrollues të cilët mbledhin dhe përpunojnë të dhëna personale të kategorive "punonjës dhe klientë".

Kontrolluesi Shoqëria "Banaj Studio shpk", është subjekt juridik me NIPT: K82013002L dhe objekt aktiviteti "Vlerësim të pasurive të paluajtshme, Projektim për kategoritë: plane rregulluese të përgjithshme për qendra të banuara, ekspertizë, konsulencë teknike inxhinjerieke etj...".

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi, sipas procesverbalit të mbajtur për këtë qëllim në datë 16.03.2018, u konstatua se:

1. Kontrolluesi nuk ka "Njoftuar" në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të ligjit.

2. Kontrolluesi nuk ka hartuar rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale;
3. Kontrolluesi nuk ka nënshkruar "*Deklaratë Konfidencialiteti*" me punëmarrësit të cilët kanë akses në përpunimin e të dhënave personale;
4. Kontrolluesi në kontratat me të tretë, me objekt: ofrimin e shërbimeve të vlerësimit të pronës, parashikon detyrimin për ruajtje të konfidencialitetit, por këto kontrata nuk janë hartuar sipas aneksit nr. 1 të Udhëzimit nr. 19 të Komisionerit, datë 03.08.2012 mbi "*Rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi.*"

Pas konstatimeve të mësipërme rezulton se:

1. Më datë 15.03.2018, mbas marrjes dijeni nëpërmjet urdhrin për kryerjen e hetimit administrativ, kontrolluesi ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit "*Formularin e Aplikimit*" për realizimin e "*Njoftimit*";
2. Kontrolluesi deklaron se është në proces hartimi të Rregullores dhe Deklaratës së Konfidencialitetit;
3. Lidhur me pikën e katërt të konstatimit, në nenin 20 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar, parashikohen ashtu si për kontrolluesit dhe "*Detyrimet e përpunuesit*" si më poshtë:

1. Kontrolluesit, për përpunimin e të dhënave personale, mund të punësojnë përpunues, të cilët garantojnë përdorimin e ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave. Çdo përpunues i të dhënave personale ka këto detyrime:

- a) të përpunojë të dhënat vetëm në përputhje me udhëzimet e kontrolluesit; të mos i transmetojë ato, përveç kur ka marrë udhëzim nga kontrolluesi;
- b) të marrë të gjitha masat e sigurisë, sipas këtij ligji dhe të punësojë operatorë, të cilët kanë detyrimin për ruajtjen e fshehtësisë;
- c) të krijojë, në marrëveshje me kontrolluesin, kushtet e nevojshme teknike dhe organizative për përmbushjen e detyrimeve të kontrolluesit, për të siguruar të drejtat e subjekteve të të dhënave personale;
- ç) t'i dorëzojë kontrolluesit, pas përfundimit të shërbimit të përpunimit, të gjitha rezultatet e përpunimit dhe dokumentacionit, që përmban të dhëna ose t'i mbajë apo t'i shkatërrojë ato me kërkesë të kontrolluesit;
- d) të vërë në dispozicion të kontrolluesit të gjithë informacionin e nevojshëm, për të kontrolluar përputhshmërinë me detyrimet, që rrjedhin sipas shkronjave të mësipërme.

Detyrimet e pikës 1 të nenit 20 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, përcaktohen në kontratën e shkruar të kontrolluesit me përpunuesin të cilat shërbejnë si model për hartimin e kontratave në vijimësi. Një fakt i tillë është materializuar në pikën 5/b dhe në pikën 9 të Udhëzimit nr.19 të Komisionerit, datë 03.08.2012 mbi “Rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi.”.

Faktet e mësipërme (mungesa e rregullores për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, mungesa e “Deklaratës së Konfidencialitetit” me punëmarrësit të cilët kanë akses në përpunimin e të dhënave personale dhe mos hartimi i kontratave me të tretë, për ofrimin e shërbimeve të vlerësimit të pronës, sipas formatit të Aneksit nr. 1 të Udhëzimit nr. 19 të Komisionerit), përbëjnë shkelje të dispozitave 20, 21, 22, 27 dhe 28 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

Nisur nga fakti që kontrolluesi u tregua bashkëpunues me grupin e kontrollit si dhe tregoi gatishmëri për riparimin e menjëhershëm të shkeljeve të konstatuara, Zyra e Komisionerit vlerëson se dalja me akt rekomandues plotëson më së miri përfundimin e këtij kontrolli.

Sa më sipër:

Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar,

REKOMANDOJ:

1. Në zbatim të nenit 27 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, kontrolluesi Shoqëria “Banaj Studio shpk”, të hartojë rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.
2. Në zbatim të nenit 28 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, kontrolluesi Shoqëria “Banaj Studio shpk”, të nënshkruajë “Deklaratë Konfidencialiteti” me punëmarrësit që kanë akses në të dhëna personale.
3. Në zbatim të nenit 20 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, kontrolluesi Shoqëria “Banaj Studio shpk”, të hartojë kontratat me të tretë, për ofrimin e shërbimeve të vlerësimit të pronës, sipas formatit të Aneksit nr. 1 të Udhëzimit nr. 19 të Komisionerit, datë 03.08.2012 mbi “Rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi.”.
4. Kontrolluesi Shoqëria “Banaj Studio shpk”, të realizojë plotësimet e detyrimeve të parashikuara në këtë Rekomandim, brenda afatit 10 ditor nga momenti i marrjes dijeni.

5. Përbushja e këtyre detyrimeve nga kontrolluesi Shoqëria "Banaj Studio shpk", përbën objekt kontrolli të vazhdueshëm nga Zyra e Komisionerit.
6. Në rast mos përbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjorbë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 6.04.2018

KOMISIONERI
Besnik Dervishi

